



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur, në vazhdimin e seancës së 50-të, të mbajtur më datë 23.07.2021 morri

VENDIM

Veprimi KSHPK-së pas lëndës së formuar sipas denoncimit me numër 12-942/1 / 1 të datës 11.02.2020 të parashtruar nga parashtrues i njohur ----- - me----- në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, pas kontrollimit të përmbajtjes së denoncimit dhe dokumentacionit shtesë, përcaktoi se nuk ka elemente për veprime të mëtejshme sipas lëndës.

Lënda me numër 12 -942/1 të datës 11.02.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Deri te parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK -së, me arsyetim.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-942/1 të datës 11.02.2020 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtruesi i njohur----- .

Denoncimi parqe ankesë kundër vendimit të IPKF----- të datës 20.01.2020, gjegjësisht. kopje të ankesës së paraqitur në Komisionin Shtetëror për të vendosur në procedurën administrative dhe procedurën e punësimit të shkallës së dytë, si dhe në Bordin Drejtues të kopshtit. Siç thuhet në denoncim, pas shpalljes së brendshme për avancimin e 4 (katër) personave për një periudhë të pacaktuar kohore të publikuar më 27.12.2019, dhe më 30.01.2020 u mor vendim për përzgjedhjen e kandidatëve dhe të pakënaqur me këtë vendim parashtruesi paraqet ankesë për shkak të gjendjes faktike të vërtetuar gabimisht dhe zbatimit të pasaktë të dispozitave të së drejtës procedurale dhe materiale. Parashtruesi pohon se i ka plotësuar të gjitha kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për punësim në pozicionin edukator-mentor.

Në denoncim pohohet se vendimi është i pashpjegueshëm, i paqartë dhe i pabazuar, sepse asnjë pjesë e vendimit nuk tregon arsyet pse institucioni vendosi të zgjedhë kandidatin e përzgjedhur për pozicionin edukator - mentor. Në vendimin e përzgjedhjes theksohet se e njëjta është miratuar në bazë të procesverbalit nr. 0401-11 / 3 nga 27.01.2020 për listën e ranguar të përgatitur nga komisioni, të cilat procesverbalet nuk u janë dorëzuar kandidatëve, as nuk është publikuar në mënyrë që kandidatët të mundën ti shohin pikat dhe listën e rangut të kandidatëve. Parashtruesi pohon se i ka plotësuar plotësisht kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, pra ka diplomë për profesor në arsimin parashkollor, 33 vjet e 3 muaj përvojë pune dhe asnjëherë nuk i është shqiptuar masë disiplinore. Parashtruesi shpreh dyshim se si është bërë përzgjedhja sepse, siç u tha nga Komisioni, gjatë përzgjedhjes administrative të kandidatëve dhe intervistës, ajo mori përgjigje pozitive dhe për këtë arsye konsideron se ky vendim është i pabazuar.

Për të përcaktuar plotësisht gjendjen faktike në lëndën hapur, Komisioni Shtetëror iu drejtua me shkrim IPKF- së ----- me kërkesë për dorëzimin e informacionit me dokumentacionin e bashkangjitur për procedurën e zhvilluar pas shpalljes së brendshme të publikuar për promovim, ankesat e mundshme në procedurë dhe vendimet e marra pas tyre.

Brenda afatit ligjor të përcaktuar, pa deklaratë nga personi përgjegjës, janë dorëzuar dokumentet nga procedura e zhvilluar, si më poshtë: pëlqimi nga Ministria e Financave, shpallje e brendshme, vendimi, procesverbali nga shqyrtimi i dokumenteve, procesverbali nga intervista, vendimi për përzgjedhjen e kandidatit, dokumente nga kandidati i zgjedhur. Në të njëjtën kohë, në shtojcë është dorëzuar edhe aktvendimi nga Komisioni Shtetëror për të vendosur në procedurën administrative dhe procedurën e punësimit të shkallës së dytë, me të cilën ankesa e mësipërme refuzohet si e pabazë, dhe thuhet se duke pasur parasysh provat e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra në procedura, komisioni vlerësoi se ankesat janë të pabazuara dhe nuk ndikojnë në përcaktimin e gjendjes faktike të ndryshme nga ajo e përcaktuar në procedurën e zhvilluar, ndërsa organi i shkallës së parë ka veprim brenda kompetencave dhe autoriteteve të përcaktuara me ligj, në mënyrë të drejtë e përcaktoi gjendjen faktike dhe të drejtën materiale e ybatoi në mënyrë të drejtë.

Bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, se nuk ka elemente për veprime të mëtejshme sipas lëndës në përputhje me nenin 17 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, për arsye se veprimi organi kompetent dhe miratoi vendim brenda kompetencave të tij.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/19), vendosi si në dispozitën të këtij vendimi.

PЃrgatiti: M.r B.K.SH, KЃshilltar
Miratoi: NB, anЃtar i KSHPK - sЃ

KOMISIONI SHTETЃOR
PЃR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska

